

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR ANËTARËSIM NË URDHRIN E FARMACISTËVE, PËR SHTETASIT E HUAJ

Çdo farmacist shtetas i huaj, që kërkon të anëtarësohet në Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë duhet të paraqitet personalisht në Këshillin Rajonal përkatës me dokumentet e mëposhtme.

- Kërkesë për anëtarësim në Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë sipas formatit të miratuar nga Këshilli Kombëtar. ([kliko këtu](#));
- Vetëdeklarim sipas formatit të miratuar nga Këshilli Kombëtar. ([kliko këtu](#))
- Fotokopje e Diplomës Universitare dhe listës së notave e perkthyer dhe noterizuar;
- Njësimin e diplomës nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- Dokument që është shpallur fitues në provimin e shtetit, i perkthyer dhe noterizuar;
- Certifikatë/vërtetim të lëshuar nga autoriteti ligjor përkatës që jep të drejtën e ushtrimit të profesionit të farmacistit në vendin e vet, ku vërtetohet se është i regjistruar, e ushtron profesionin dhe nuk ka marrë masa ndëshkimore. Ky vërtetim lëshohet në dy kopje, njëra kopje e mbyllur në zarf dhe e vulosur nga autoriteti ligjor përkatës dhe kopja tjetër e perkthyer dhe noterizuar;
- Dëshmi të njohjes së gjuhës shqipe niveli C1, të lëshuar nga një autoritet i licencuar nga shteti;
- Fotokopje e kartës së identitetit ose pasaportës;
- Kontratë pune me subjektin (nëse është i/e punësuar), firmosur dhe vulosur nga punëdhënësi;
- Fotokopje e certifikatës së regjistrimit të subjektit farmaceutik në QKB;
- Fotokopje e licencës së QKL/QKB të subjektit farmaceutik;
- Fotokopje e certifikatës të drejtuesit teknik të subjektit farmaceutik ku do të punësohet, lëshuar nga UFSH;
- Mandat pagesa:
 - 1500 lekë - për tarifën e regjistrimit.
 - 5000 lekë - për lejen e ushtrimit të profesionit
- Certifikatë të gjendjes civile nëse ka ndryshime të të dhënave personale (ndryshim emri/mbiemri);
- Tre fotografi 3 x 3.5 cm;
- Deklarata e pronarit të subjektit farmaceutik, sipas nenit 19 të Statutit të UFSH-së (nëse pronari është jo farmacist). ([kliko këtu](#))
- Lejen e qëndrimit dhe të punës në Republikën e Shqipërisë;
- Shkresë përcjellëse lëshuar nga Presidenti i Këshillit Rajonal përkatës.